

## **Konventë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.**

*Paris, më 17 tetor 2003*

**Konferenca e përgjithshme** e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin shkencën dhe kulturën më poshtë e quajtur “UNESCO”, e mbledhur në Paris nga 29 shtatori deri në 17 tetor 2003 në sesionin e 32-të të saj,

**Duke iu referuar** instrumenteve ndërkombëtarë ekzistues lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti Deklaratës së përbotshme për të drejtat e njeriut të 1948-ës, Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 1966-ës dhe Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të 1966-ës,

**Duke marrë parasysh** rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përmbledhëse e diversitetit kulturor dhe garanci e zhvillimit afatgjatë, siç theksohet në Rekomandimin e UNESCO-s për mbrojtjen e kulturës tradicionale dhe popullore të 1989-s, në Deklaratën e përbotshme të UNESCO-s për diversitetin kulturor të vitit 2001 dhe në Deklaratën e Stambollit të vitit 2002 miratuar në Tryezën e tretë të Rrumbullaktë të ministrave të kulturës,

**Duke marrë parasysh** ndërvarësinë midis trashëgimisë kulturore jomateriale dhe trashëgimisë materiale kulturore dhe natyrore,

**Duke pranuar** se proceset e mondializimit dhe të ndryshimit shoqëror, krahas kushteve që krijojnë për një dialog të përtërirë mes bashkësive, shkaktojnë gjithashtu, njësoj si dhe dukuritë e mostolerancës, kërcënime të rënda për degradim, për zhdukje dhe shkatërrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, veçanërisht për faktin e mungesës së mjeteve për ruajtjen e kësaj të fundit,

**E ndërgjegjshme** për vullnetin e përbotshëm dhe për shqetësimin e përbashkët për të ruajtur trashëgiminë kulturore jomateriale të njerëzimit,

**Duke pranuar** se bashkësitë, në veçanti bashkësitë rrënjëse, grupet dhe, sipas rastit, individët, luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke

ndihmesuar kështu për pasurimin e diversitetit kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore,

**Duke shënuar** shtrirjen e madhe të veprimtarisë së kryer nga UNESCO-ja për të ndërtuar instrumentet normativë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, vepër mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht Konventën për mbrojtjen e trashëgimisë botërore, kulturore dhe natyrore të vitit 1972,

**Duke shënuar** gjithashtu se deri më tani nuk ka asnjë instrument shumëpalësh me karakter shtrëngues që të synojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale,

*Duke patur parasysh se marrëveshjet, rekomandimet dhe rezolutat ndërkombëtare që ekzistojnë lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore do të duhej të pasuroheshin dhe të plotësoheshin në mënyrë të frytshme me anë të dispozitave të reja lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale,*

**Duke patur parasysh** detyrimin e bashkësisë ndërkombëtare për të dhënë ndihmesën me shtetet palë në këtë Konventë për ruajtjen e kësaj trashëgimie në një frymë bashkëpunimi dhe ndihme të ndërsjellë,

**Duke sjellë në vëmendje** programet e UNESCO-s lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale, sidomos Shpalljen e kryeveprave të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit,

**Duke patur parasysh** rolin e paçmueshëm të trashëgiminë kulturore jomateriale si faktor afrimi, shkëmbimesh dhe kuptimi midis qenieve njerëzore,

**Miraton,** më 17 tetor 2003, këtë Konventë.

## **Dispozita të përgjithshme**

### **Neni 1: Qëllimet e Konventës**

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

- (a) ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale;

- (b) respektimi i trashëgimisë kulturore jomateriale të bashkësive, të grupeve dhe të individëve të prekur;
- (c) sensibilizimi në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë;
- (d) bashkëpunimi dhe asistenca ndërkombëtare.

## ***Neni 2: Përkufizime***

Për qëllimet e kësaj Konvente,

1. Me “trashëgimi kulturore jomateriale” kuptohen praktikrat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dijeberja (savoir faire) – si dhe veglat, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato – që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, përcjellë brez pas brezi, është rikrijuar në vijimësi nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke ndihmesuar kështu për promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Për qëllimet e kësaj Konvente do të merret parasysh vetëm trashëgimia kulturore jomateriale në përputhje me instrumentet ndërkombëtare ekzistuese lidhur me të drejtat e njeriut, si dhe me kërkesën për respektim të ndërsjellë ndërmjet bashkësive, grupeve dhe individëve, dhe me një zhvillim afatgjatë.

2. “Trashëgimia kulturore jomateriale”, siç është përcaktuar në paragrafin 1 më sipër, shfaqet sidomos në fushat e mëposhtme:
  - (a) traditat dhe shprehjet gojore, përfshirë këtu edhe gjuha si vektor i trashëgimisë kulturore jomateriale;
  - (b) artet e shfaqjes (spektaklit);
  - (c) praktikrat sociale, ritualet dhe ngjarjet festive;
  - (d) njohjet dhe praktikrat lidhur me natyrën dhe gjithësinë;
  - (e) dijeberja (savoir-faire) lidhur me artizanatin tradicional;
3. Me “ruajtje” kuptohen masat që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin,

- kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, vlerësimin, përcjelljen, kryesisht përmes edukimit formal dhe joformal, si dhe rigjallërimi i aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie.
4. Me “shtete palë” kuptohen shtetet që janë të lidhur nga kjo Konventë dhe midis të cilëve kjo është në fuqi.
  5. Kjo Konventë zbatohet *mutatis mutandis* në territoret e parashikuara në nenin 33 që bëhen palë në të, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen. Kështu, shprehja “shtete palë” kuptohet edhe për këto territore.

### ***Neni 3: Lidhje me instrumente të tjera ndërkombëtare***

Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet si:

- (a) ndryshim i statusit a ulje e nivelit të mbrojtjes së pasurive të deklaruara të trashëgimisë botërore në kuadrin e Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore, kulturore dhe natyrore, të vitit 1972, me të cilët një element i trashëgimisë kulturore jomateriale është i lidhur drejtpërdrejt; ose
- (b) prekje e të drejtave dhe detyrimeve të shteteve palë që rrjedhin nga çdo instrument ndërkombëtar lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale ose me përdorimin e burimeve biologjike dhe ekologjike ku ata janë palë.

## **Organet e Konventës**

### **Neni 4: Asambleja e përgjithshme e shteteve palë**

Është ngritur një Asamble e përgjithshme e shteteve palë, më poshtë e quajtur “Asamble e përgjithshme”. Asambleja e përgjithshme është organi sovran i kësaj Konvente.

Asambleja e përgjithshme mblidhet në sesion të zakonshëm çdo dy vjet. Ajo mund të mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse ajo vendos kështu ose nëse asaj i është drejtuar kërkesë nga Komiteti

ndërqeveritar i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale ose nga jo më pak se një e treta e shteteve palë.

Asambleja e përgjithshme miraton rregulloren e saj të brendshme.

#### **Neni 5: Komiteti ndërqeveritar i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale**

1. Pranë UNESCO-s është ngritur një Komitet ndërqeveritar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, më poshtë i quajtur “Komiteti”. Ai përbëhet nga përfaqësues të 18 shteteve palë, të zgjedhur nga shtetet palë mbledhur në Asamble të përgjithshme me të hyrë në fuqi kjo Konventë, në përputhje me nenin 34.
2. Numri i shteteve anëtare të Komitetit do të bëhet 24 me të arritur në 50 numri i shteteve palë në Konventë.

#### **Neni 6: Zgjedhja dhe mandati i shteteve anëtare të Komitetit**

1. Zgjedhja e shteteve anëtare të Komitetit duhet të respektojë parimet e shpërndarjes gjeografike dhe të rotacionit të rregullt.
2. Shtetet anëtare të Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar nga shtetet palë në konventë të mbledhur në Asamble të përgjithshme.
3. Megjithatë, mandati i gjysmës së shteteve anëtare të Komitetit të zgjedhura gjatë zgjedhjes së parë kufizohet në dy vjet. Këto shtete përcaktohen me një short të hedhur gjatë kësaj zgjedhjeje të parë.
4. Çdo dy vjet Asambleja e përgjithshme bën përteritjen e gjysmës së shteteve anëtare të Komitetit.
5. Gjithashtu ajo zgjedh aq shtete anëtare të Komitetit sa nevojiten për të plotësuar vendet e lira.
6. Një shtet anëtar i Komitetit nuk mund të zgjidhet për dy mandate të njëpasnjëshëm.

7. Shtetet anëtare të Komitetit zgjedhin për t'i përfaqësuar persona të kualifikuar në fushat e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale.

## **Neni 7: Funkcionet e Komitetit**

Pa cenuar atributet e tjera që i janë dhënë nga kjo Konventë, funksionet e Komitetit janë si më poshtë:

- promovim i objektivave të Konventës, nxitje dhe garantim i vijimësisë për zbatimin e saj;
- dhënie e këshillave për praktikat më të mira dhe formulim i rekomandimeve për masat në favor të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale;
- përgatitja dhe paraqitja për miratim në Asamblenë e përgjithshme e një projekti për përdorimin e burimeve të Fondit, në përputhje me nenin 25;
- përpjekje për të gjetur mjetet për shtimin e burimeve të tij dhe marrja e masave të nevojshme për këtë qëllim, në përputhje me nenin 25;
- përgatitja dhe paraqitja për miratim në Asamblene e Përgjithshme e direktivave operacionale për zbatimin e Konventës;
- shqyrtimi, në përputhje me nenin 29 i raporteve të shtetëve palë, dhe bërja e një përmbledhjeje për këtë për ti paraqitur Asamblesë së përgjithshme;
- shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga shtetet palë dhe vendimmarrja, në përputhje me kriteret objektive të përzgjedhjes të vendosura prej tij dhe të miratuara nga Asambleja e përgjithshme;
- regjistrime në lista të propozimeve të përmendura në nenet 16,17 dhe 18;
- dhënia e mbështetjes ndërkombëtare në përputhje me nenin 22.

## **Neni 8: Metoda të punës së Komitetit**

1. Komiteti përgjigjet përpara Asamblesë së përgjithshme. Ai i jep llogari për të gjitha veprimtaritë dhe vendimet.
2. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendëshme me shumicën e dy të tretave të antarëve të tij.

3. Komiteti mund të krijojë përkohësisht organe këshillimore ad-hoc të cilat i gjykon të nevojshme për zbatimin e detyrave të tij.
4. Komiteti mund të ftojë në mbledhjet e tij organizma publikë ose privatë, si dhe persona fizikë, që kanë kompetenca të mirënjohura në fushë të ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale, për tu këshilluar me ta për çështje të veçanta.

### **Neni 9: Akreditimi i organizatave këshillimore**

1. Komiteti i propozon asamblesë së përgjithshme akreditimin e organizatave joqeveritare që kanë kompetenca të mirënjohura në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Këto organizata do të kenë funksione këshillimore pranë Komitetit.
2. Komiteti i propozon gjithashtu Asamblesë së përgjithshme kriteret dhe modalitetet e këtij akreditimi.

### **Neni 10: Sekretariati**

1. Komiteti mbështetet nga Sekretariati i UNESCO-s.
2. Sekretariati përgatit dokumentacionin e Asamblesë së përgjithshme dhe të Komitetit, si dhe projektin e rendit të ditës të mbledhjeve të tyre dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre.

### **Ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale në shkallë kombëtare**

#### **Neni 11: Roli i shteteve palë**

I përket çdo shteti palë:

- (a) të marrë masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij;
- (b) ndërmasat e ruajtjes të parashikuar në nenin 2, paragrafi 3 për të identifikuar dhe përcaktuar elementët e ndryshëm të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij, me pjesëmarrjen e bashkësive, të grupeve dhe të organizatave joqeveritare.

#### **Neni 12: Inventarët:**

- 1 Për të siguruar identifikimin për ruajtjen, çdo shtet palë, në përputhje me gjendjen e tij, harton një ose më shumë inventarë të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij. Këto inventare janë objekt i një përditësimi të rregullt.
- 2 Cdo shtet palë, kur i paraqit periodikisht raportin Komitetit, në përputhje me nenin 29, jep informacione domethënëse lidhur me këto inventare.

### **Neni 13: Masa të tjera ruajtjeje**

Me qëllim që të sigurohet ruajtja, zhvillimi dhe venia në pah e trashëgimisë kulturore jomateriale, e pranishme në territorin e tij, çdo shtet palë përpiqet:

- (a) Të hartojë një politikë të përgjithëshme, që të synojë vënien në pah të funksionit të trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri dhe të integrojë ruajtjen e kësaj trashëgimie në programe planifikimi;
- (b) Të caktojë ose të ngrrejë një ose disa organizma kompetentë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij;
- (c) Të nxisë studime shkencore, teknike dhe artistike si dhe metodologji kërkimore për një ruajtje të efektshme të trashëgimisë kulturore jomateriale, në veçanti të trashëgimisë kulturore jomateriale në rrezik;
- (d) Të miratojë masat juridike, teknike, administrative dhe financiare përkatëse me synim:
  - (i) Favorizimin e krijimit ose të forcimit të institucioneve për formim në administrim të trashëgimisë kulturore jomateriale si dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie përmes forumeve dhe hapësirave të destinuara për paraqitjen dhe shprehjen e saj;
  - (ii) Garantimin e shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore jomateriale gjithë duke respektuar praktikat zakonore që rregullojnë shfrytëzimin në disa aspekte specifike të kësaj trashëgimie;



- (iii) Ngritjen e institucioneve dokumentare për trashëgiminë kulturore jomateriale dhe mundësimin e shfrytëzimit të tyre

#### **Neni 14: Edukimi, sensibilizimi dhe rritja e kapaciteteve**

Çdo shtet palë përpiqet me të gjitha mjetet përkatëse:

- (a) të sigurojë njohjen, respektimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri, veçanërisht me:
  - (i) programe edukative, sensibilizues dhe përhapës të informacionit për publikun, sidomos për të rinjtë;
  - (ii) programe të posaçme për edukim dhe formim, brenda bashkësive dhe grupeve të interesuar;
  - (iii) veprimtari për forcimin e kapaciteteve në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale dhe në veçanti për administrimin dhe kërkimin shkencor; dhe
  - (iv) mjete joformale të përcjelljes së dijeve;
- (b) të mbajë publikun të informuar për kërcënimet që rëndojnë mbi këtë trashëgimi si dhe për veprimtaritë e kryera për të zbatuar këtë Konventë;
- (c) të promovojë edukimin për mbrojtjen e hapësirave natyrore dhe të vendeve historike ekzistenca e të cilëve është e nevojshme për shprehjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.

#### **Neni 15: Pjesëmarrje e bashkësive, grupeve dhe individëve**

Në kuadrin e veprimtarive të tij për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, çdo shtet palë përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen më të madhe të mundshme të bashkësive, të grupeve dhe, sipas rastit, të individëve që krijojnë, mirëmbajnë dhe përcjellin këtë trashëgimi, dhe t'i përfshijnë gjallërisht në administrimin e saj.

#### **Ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale në shkallë ndërkombëtare**

## **Neni 16: Lista paraqitëse e trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit**

Për të siguruar një shikueshmëri më të mirë të trashëgimisë kulturore jomateriale, të punohet për një ndërgjegjësim më të mirë të rëndësisë së saj dhe për të favorizuar dialogun duke respektuar diversitetin kulturor, Komiteti, me propozim të shteteve palë të interesuara harton, përditëson dhe publikon një listë paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit.

Komiteti harton dhe i paraqit për miratim Asamblesë së përgjithshme kriteret kryesore për hartimin, përditësimin dhe publikimin e kësaj liste paraqitëse.

## **Neni 17: Lista e trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë të ngutshme për ruajtje**

1. Për të marrë masat përkatëse për ruajtje Komiteti harton, përditëson dhe publikon një listë të trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë të ngutshme për ruajtje, dhe e regjistron këtë trashëgimi në Listën e kërkuar nga shteti palë i interesuar.
2. Komiteti harton dhe i paraqit për miratim Asamblesë së përgjithshme kriteret kryesore për hartimin, përditësimin dhe publikimin e kësaj liste.
3. Në rast të një ngutshmërie të skajshme – për të cilën kriteret objektive janë miratuar nga Asambleja e përgjithshme me propozim të Komitetit – ky i fundit mund të regjistrojë një element të trashëgimisë në fjalë në Listën e përmendur në paragrafin 1 duke u këshilluar me shtetin palë të interesuar.

## **Neni 18: Programe, projekte dhe veprimtari për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale**

1. Në bazë të propozimeve të paraqitura nga shtetet palë, dhe në përputhje me kriteret që ai përcakton dhe që janë miratuar nga Asambleja e përgjithshme, Komiteti përzgjedh periodikisht dhe promovon programe, projekte dhe veprimtari me karakter kombëtar, nënrajonat ose rajonat për ruajtjen e trashëgimisë që ai i

gjykon se pasqyrojnë më mirë parimet dhe objektivat e kësaj Konvente, duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim.

2. Për këtë qëllim ai merr, shqyrton dhe miraton kërkesat për mbështetje ndërkombëtare të formuluar nga shtetet palë për hartimin e këtyre propozimeve.
3. Komiteti e shoqëron zbatimin e këtyre programeve, projekteve dhe veprimtarive me përhapjen e praktikave më të mira sipas modaliteteve të paracaktuara prej tij.

## **Bashkëpunim dhe mbështetje ndërkombëtare**

### **Neni 19: Bashkëpunim**

Për qëllimet e kësaj Konvente, bashkëpunimi ndërkombëtar përfshin në veçanti shkëmbimin e informacioneve dhe të përvojave, të nismave të përbashkëta si dhe ngritjen e një mekanizmi për të mbështetur shtetet palë në përpjekjet e tyre për të ruajtur trashëgiminë kulturore jomateriale.

Pa cënuar dispozitat e legjislacionit të tyre kombëtar dhe të të drejtave dhe praktikave zakonore të tyre, shtetet palë pranojnë që ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale është në interesin e përgjithshëm të njerëzimit dhe zotohen, për këtë qëllim, të bashkëpunojnë në nivelet dypalëshe, nënrajonale, rajonale dhe ndërkombëtare.

### **Neni 20: Objektivat e mbështetjes ndërkombëtare**

Mbështetja ndërkombëtare mund të jepet për objektivat e mëposhtëm:

- (a) Ruajtje e trashëgimisë së regjistruar në Listën e trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë për ruajtje të ngutshme;
- (b) Përgatitje e inventarëve në kuptimin e neneve 11 dhe 12;
- (c) Mbështetje për programet, projektet dhe veprimtaritë e orientuara në nivel kombëtar, nënrajonar dhe rajonal, që synojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- (d) Çdo objektiv tjetër që Komiteti do ta gjykonte të nevojshëm.

## **Neni 21: Forma të mbështetjes ndërkombëtare**

Mbështetja e dhënë nga Komiteti për një shtet palë rregullohet me direktiva operacionale të parashikuara në nenin 7 dhe nga marrëveshja e përcaktuar në nenin 24, dhe mund të marrë format e mëposhme:

- (a) Studime lidhur me aspekte të ndryshme të ruajtjes;
- (b) Vënie në dispozicion e ekspertëve dhe zbatuesve;
- (c) Formimi i gjithë personelit të nevojshëm;
- (d) Hartimi i masave normative ose të tjera;
- (e) Krijimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturave;
- (f) Furnizimi me pajisje dhe me dijebërje (savoir-faire);
- (g) Forma të tjera mbështetje financiare dhe teknike përfshirë aty, sipas rastit, dhënien e kredive me interes të ulët dhe donacione.

## **Neni 22: Kushtet për mbështetje ndërkombëtare**

1. Komiteti harton procedurën e shqyrtimit të kërkesave për mbështetje ndërkombëtare dhe përcakton elementet e kërkesës siç janë masat e parashikuara, ndërhyrjet e nevojshme dhe vlerësimi i kostos së tyre.
2. Në rast urgjence, kërkesa për mbështetje duhet të shqyrtohet me përparësi nga Komiteti.
3. Me qëllim që të merret një vendim, Komiteti bën studimet dhe këshillimet që ai i gjykon të nevojshme.

## **Neni 23: Kërkesat për mbështetje ndërkombëtare**

1. Çdo shtet palë mund t'i paraqitë Komitetit një kërkesë për mbështetje ndërkombëtare për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij.
2. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet bashkërisht edhe nga dy ose më shumë shtete palë.
3. Kërkesa duhet të përmbajë elementet e informacionit parashikuar në nenin 22, paragrafi 1, dhe dokumentet e nevojshme.

## **Neni 24: Roli i shteteve palë përfitues**

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mbështetja ndërkombëtare e dhënë rregullohet me një marrëveshje ndërmjet shtetit palë përfitues dhe Komitetit.
2. Si rregull i përgjithshëm shteti palë përfitues duhet të marrë pjesë, brenda mundësive të tij, në koston e masave ruajtëse për të cilat është dhënë një mbështetje ndërkombëtare.
3. Shteti palë përfitues i paraqit Komitetit një raport për përdorimin e mbështetje së dhënë në favor të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale.

## **Fondi i trashëgimisë kulturore jomateriale**

### **Neni 25: Natyra dhe burimet e fondit**

Është krijuar një “ Fond për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale”, mëposhtë i quajtur “Fondi”.

Fondi përbëhet nga fond-i-depozituar në përputhje me dispozitat e Rregullores financiare të UNESCO-s.

Burimet e fondit përbëhen nga :

Kontributet e shteteve palë;

Fondet e dhëna për këtë qëllim nga Konferenca e përgjithshme e UNESCO-s;

Derdhjet, dhurimet dhe lëniet në trashëgim që mund të bëjnë:

(i) Shtetet e tjerë;

(ii) Organizatat dhe programet e sistemit të Kombeve të Bashkuara, sidomos programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillimin, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare;

(iii) Organizma publikë ose privatë ose persona privatë;

Çdo interes që duhet të kalojë në burimet e Fondit;

Produkti i mbledhjes së fondeve dhe i të ardhurave nga manifestimet e organizuara në dobi të Fondit;

Të gjitha burimet e tjera të autorizuara nga rregullorja e Fondit të hartuar nga Komiteti.

Përdorimi i burimeve nga Komiteti përcaktohet në bazë të orientimeve të Asamblesë së përgjithshme.

Komiteti mund të pranojë kontribute dhe forma të tjera mbështetjeje të dhëna për qëllime të përgjithshme ose të veçanta në lidhje me projekte të përcaktuara, me kusht që këto projekte të jenë miratuar nga Komiteti.

Kontributet në Fond nuk mund të shoqërohen me asnjë kusht politik, ekonomik a tjetër në mospërputhje me objektivat e përcaktuara nga kjo Konventë.

## **Neni 26: Kontribute të shteteve palë në Fond**

1. Pa cënuar asnjë kontribut vullnetar shtesë, shtetet palë në këtë Konventë zotohen të derdhin në Fond, së paku çdo dy vjet, një kontribut shuma e të cilit, e përlllogaritur sipas një përqindjeje uniforme e zbatueshme për të gjitha shtetet, do të vendoset nga Asambleja e përgjithshme. Ky vendim i Asamblesë së përgjithshme do të merret me shumicën e shteteve palë të pranishme dhe që votojnë të cilat nuk kanë bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni. Në asnjë rast, ky kontribut nuk mund të tejkalojë një përqind të kontributit të shtetit palë në buxhetin e zakonshëm të UNESCO-s.
2. Megjithatë, çdo shtet i parashikuar në nenin 32 ose në nenin 33 të kësaj Konvente, në çastin e depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, mund të deklarojë që ai nuk do të jetë i lidhur me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.
3. Një shtet palë i kësaj Konvente që ka bërë deklaratën e parashikuar në neni 2 të këtij neni do të përpiqet të tërheqë të ashtuquajturën deklaratë duke venë në dijeni Drejtorin e përgjithshëm të UNESCO-s. Sidoqoftë, tërheqja e deklaratës do të veprojë për kontributin që duhet të japë ky shtet vetëm pas datës së hapjes së sesionit pasardhës të Asamblesë së përgjithshme.

4. Me qëllim që Komiteti të ketë mundësi të parashikojë operacionet e veta në mënyrë të efektshme, kontributet e shteteve palë në këtë Konventë që kanë bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të derdhen rregullisht, të paktën çdo dy vjet, dhe do të duhej të afroheshin mundësisht sa më shumë me kontributet që do të ishte dashur të derdhnin ata nëse do të kishin qenë të lidhur me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

5. Çdo shtet palë në këtë konventë, i vonuar në pagesën e kontributit të tij të detyrueshëm ose vullnetar për vitin në vijim dhe të vitit kalendarik (civil) paraardhës, nuk është i zgjedhshëm në Komitet, por kjo dispozitë nuk është e zbatueshme gjatë zgjedhjes së parë. Mandati i një shteti të tillë që është tashmë anëtar i Komitetit do të përfundojë në çastin e çdo zgjedhjeje të parashikuar në nenin 6 të kësaj Konvente.

#### ***Neni 27: Kontribute vullnetare shitesë në Fond***

Shtetet palë që dëshirojnë të derdhin kontribute vullnetare përveç atyre të parashikuara në nenin 26, informojnë për këtë Komitetin sa më shpejt që të jetë e mundur me qëllim që, si pasojë, ky të ketë mundësi të planifikojë veprimtaritë e tij.

#### ***Neni 28: Fushata ndërkombëtare për grumbullim fondesh***

Shtetet palë, brenda mundësive, japin ndihmesën e tyre në fushatat ndërkombëtare për grumbullim të organizuara në dobi të Fondit nën kujdesin e UNESCO-s.

## **VII. Raporte**

#### ***Neni 29: Raportet e shteteve palë***

Shtetet palë i paraqisin Komitetit, në format dhe sipas periodikësisë së përcaktuar nga ky i fundit, raporte për dispozitat ligjore, rregulluese e të tjera të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

### ***Neni 30: Raportet e Komitetit***

1. Mbështetur në veprimtaritë e tij dhe në raportet e shteteve palë të përmendura në nenin 29, Komiteti paraqit një raport në çdo sesion të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Ky raport i bëhet i ditur Konferencës së përgjithshme të UNESCO-s.

## **VIII. Klauzola kalimtare**

### **Neni 31: Marrëdhënie me Shpalljen e kryeveprave të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit**

1. Komiteti përfshin në Listën paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit elementet e shpallura "Kryevepra të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit" para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.
2. Përfshirja e këtyre elementeve në Listën paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit nuk paragjykon aspak kriteret e përcaktuara në përputhje me nenin 16, paragrafi 2, për regjistrimet e ardhshme.
3. Asnjë Shpallje tjetër nuk do të bëhet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

## **IX. Dispozita të fundit**

### **Neni 32: Ratifikimi, pranimi ose miratimi**

1. Kjo Konventë i është nënshtruar ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare të UNESCO-s, në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.
2. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s.



### **Neni 33: Aderimi**

1. Kjo Konventë është e hapur për të aderuar çdo shtet jo anëtar i UNESCO-s i ftuar për të aderuar në të nga Konferenca e përgjithshme e Organizatës.
2. Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për të aderuar territoret që gëzojnë një autonomi të brendshme të plotë, të njohur si e tillë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, por që nuk kanë arritur në pavarësinë e plotë në përputhje me rezolutën 1514 (XV) të Asamblesë së përgjithshme dhe që janë kompetente për lëndët që trajton kjo Konventë, përfshirë këtu kompetencën e njohur për të përfunduar traktate në këto lëndë.
3. Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s.

### **Neni 34: Hyrja në fuqi**

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, por vetëm për shtetet që do të kenë depozituar instrumentet e tyre përkatëse të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit në këtë datë ose më parë. Ajo do të hyjë në fuqi për çdo shtet tjetër palë tre muaj pas depozitimit të të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit.

### **Neni 35: Regjimet kushtetuese federative ose jo të njësuar**

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për shtetet palë që kanë një regjim kushtetues federativ ose jo të njësuar:

- (a) lidhur me dispozitat e kësaj Konvente zbatimi i të cilave është kompetencë e pushtetit legjislativ federal ose qendror, detyrimet e qeverisë federale ose qendrore do të jenë të njëjta me ato të shteteve palë që nuk janë shtete federativë;
- (b) lidhur me dispozitat e kësaj Konvente zbatimi i të cilave është kompetencë e secilit shtet, vend, provincë ose kanton përbërës, që në bazë të regjimit kushtetues të federatës nuk kanë detyrë të

marrin masa legislative, qeveria federale, me mendimin e saj të favorshëm, do t'ua bëjë të ditur këto dispozita autoriteteve kompetente të shteteve, vendeve, provincave ose kantoneve për miratim.

### **Neni 36: Denoncimi**

1. Secili nga shtetet palë ka mundësinë të denoncojë këtë Konventë.
2. Denoncimi bëhet i ditur me anë të një instrumenti të shkruar të depozituar pranë Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s.
3. Denoncimi bëhet i efektshëm dymbëdhjetë muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Ai nuk ndryshon në asgjë detyrimet financiare të cilat shteti palë denoncues është i detyruar të shlyejë deri në datën kur tërheqja bëhet e efektshme.

### **Neni 37: Funkcionet e ruajtësit**

Drejtori i përgjithshëm i UNESCO-s, me cilësinë e ruajtësit të kësaj Konvente, informon shtetet anëtare të Organizatës, shtetet joanëtare të parashikuara në nenin 33, si dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara, për depozitim të të gjitha instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të përmendura në nenet 32 dhe 33 si dhe të denoncimeve të parashikuara në nenin 36.

### **Neni 38: Amendimet**

1. Çdo shtet palë, me anë të komunikimit me shkrim drejtuar Drejtorit të përgjithshëm, mund të propozojë amendime për këtë Konventë. Drejtori i përgjithshëm ua përcjell këtë komunikim të gjitha shteteve palë. Nëse, në gjashtë muajt pasardhës nga data e përcjelljes së komunikimit, së paku gjysma e shteteve palë jep një përgjigje pozitive për këtë kërkesë, Drejtori i përgjithshëm e paraqit këtë propozim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së përgjithshme për diskutim dhe nëse është e mundur për miratim.
2. Amendimet miratohen me shumicën e dy të tretave të shteteve palë të pranishëm dhe votues.

3. Amendimet për këtë Konventë, pasi janë miratuar, u paraqiten shteteve palë për ratifikim, pranim, miratim ose aderim.
4. Për shtetet palë që i kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose që kanë aderuar, amendimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të parashikuar në paragrafin 3të këtij neni nga dy të tretat e shteteve palë. Në vijim, për çdo shtet palë që ratifikon, pranon, miraton një amendim ose aderon në të, ky amendim hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga shteti palë të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit.
5. Procedura e vendosur në paragrafet 3 dhe 4 nuk zbatohet për amendimet e sjella në nenin 5 lidhur me numrin e shteteve anëtare të Komitetit. Këto amendime hyjnë në fuqi në çastin e miratimit të tyre.
6. Një shtet që bëhet palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të amendimeve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, në mungesë të shprehjes së një qëllimi ndryshe, shihet sikur është:
  - (a) palë në këtë Konventë të amenduar kështu; dhe
  - (b) palë në këtë Konventë të paamenduar për çdo shtet palë që nuk është i lidhur nga këto amendime.

### **Neni 39: Tekste të besueshme**

Kjo Konventë është hartuar në anglisht, në arabisht, në kinezisht, në spanjisht, në frengjisht dhe në rusisht, të gjashtë tekstet njëlloj të besueshëm.

### **Neni 40: Regjistrimi**

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s.

Bërë në Paris, më tre nëntor 2003, në dy kopje autentike që mbajnë firmën e Presidentit të sesionit të 32-të të Konferencës së përgjithshme dhe të Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s. Këto dy kopje do të depozitohen në arkivat e UNESCO-s. Kopje të certifikuar në përputhje do t'u jepen të

gjitha shteteve të parashikuara në nenet 32 dhe 33 si dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

*Data e miratimit 2003*